

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

## KOMUNA E SHTIMES

### KONTRATË

**Komuna Shtime** Rr. „Tahir Sinani „ tel. 0290-389-016-131që e përfaqëson Drejtori i Prokurimit Muhadin Halili në njërën anë;

dhe

Grup i OE,, Migrant Ing ,, shpk dhe Lumjet Havolli Blakqori BI ,, nga Prishtina që përfaqsohet nga e autorizuar e grupit ,Gresa Blakqori telefoni: 045-438-270 tel ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

„Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari,,

Nr. i Prokurimit 617-20-4196-4-2-3

Nr. i brendshëm 617-2020-053-423

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës : Realizimi i shtatores kushtuar Heroit Kombëtar Komandantit Legjendar Adem Jashari , sipas kërkesave të specifikuar . Shprehja figurave artistike e shtatores duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapsiren e sheshit në të cilën planifikohet të vendoset figura në bronzë.

Shtatorja si koncept në vehte duhet të jetë shprehje artistike dhe figurative me të cilën kjo reflekton tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari. Kompozimi i shtatores do të përfshijë pamjen figurative të Heroit Kombëtar Adem Jashari .

Lartësia e shtatores duhet të jetë ( Orijetuese) 300-350 cm .Materiali i fortë përfundimtar i shtatores është bronzi . Në çmim duhet të kalkulohej të gjitha shpenzimet : Punimi i bustit , transporti , sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në pstatment . Realizuesi i shtatores duhet të shënoj , gaveroj edhe emrin mbiemrin datën e lindjes dhe datën e vdekjes.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e kontrates nga te dy palët, dhe përfundon më datë 28/12/2021

1.3 Vendi i vendosjes së shtatores do të jetë në Qytetin e Shtimes, Sheshi i UÇK-së , i cili do të vendoset në bashkëpunim me menaxherin e kontratës dhe subjektet relevante të komunës . Datat e vendosjes së Shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari, do të jenë një ndër datat historike të Komunës së Shtimes si : 12 Qershori , dita e Çlirimit të Komunës, 26 korriku Dita e Dëshmorëve të Komunës së Shtimes , si dhe 28 Nëntori Shpallja e Pavarisë së Shqipërisë dhe ditëlindja e Komandantit Adem Jashari. OE është i obliguar që Shtatoren ta ketë gati më 12 qershor , e cila datë është më e përafërta për vendosjen e Shtatores.

#### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi i përgjithshëm i kontratës për ndërtimin e shtatoreve dhe pllakes përkujtimore shprehur me numra është **69,900.00 €; ose shprehur me fjalë Gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqindë Euro.**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

**Në çmim të kalkulohen të gjitha shpenzimet: punimi i bustit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament.**

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të bëhet si në vijim: Pagesa do të bëhet nga buxheti i vitit 2020 dhe 2021 në bazë të situatave (Çertifikatave) të verifikuara nga Menaxheri i kontratës.

**OE duhet të sjell këto dokumente për pagesën e fundit :**

**1.Garancionin për ( 12 muaj )2.Raporti i pranimit teknik nga komisioni.3.Situacioni përfundimtar .4.Fatura e rregullt.5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e shtatores .**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i punimit të shtatores duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe të paraqitura në buçetën e dorëzuar me rastin e aplikimit në konkurs projektimi.

6.2 Nëse komisioni për pranim konstaton se kontraktuesi nuk i është përmbajtur kushteve për ndërtimin e shtatores dhe nuk i ka tiparet që janë paraqitur në buçet nuk do të pranohet dhe nuk do të lejohet vendosja dhe nuk do të paguhet.

## **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të Shtatores ,furnizuesi është i obliguar të dorëzojë sigurimin kualitetit të punës dhe materialit për punimin e shtatores.

*Kontraktuesi do të garantojë për materialin e përdorur se do të jetë rezistencë ndaj kushteve klimatike me garancion bankar ose kompani të sigurimit të rregullt 1 vjeçar pas pranimit teknik në vlerë prej 10% te vlerës së kontratës.*

***Kontraktuesi është përgjegjës për shtatoren deri në momentin e përfundimit d.m.th zbulimit të shtatores që njëherit konsiderohet pranim i punës së kryerë.***

## **Neni 8 Sigurimi i ekzekutimit**

Kontraktuesi do të paguj sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej **10% të shumës së përgjithshme te kontratës për një periudhë prej 12 muajve**

## **Neni 9 Vonesat në ekzekutim**

9.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punimeve te shtatoreve dhe të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 10 Inspektimi dhe testimi**

10.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, ndërtimit të shtatores që do të ndërtohen për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 112 Nën-kontraktimi**

11.1 kontraktuesi nuk ka të drejtë të nënkontraktojë ndërtimin e shtatores , shtatoren është i obliguar t'i ndërtojë vetë,sipas marrëveshje së konzorciumit. Kontraktuesi nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga

autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

### **Neni 13 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

13.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

### **Neni 14 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

14.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata thelore në Lipjan në pajtim me ligjin e Kosovës.

### **Neni 15 Komunikimi**

15.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.


Kjo kontratë është hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.



#### **Për Operatorin Ekonomik**

#### **Për Autoritetin Kontraktues**

<b>Emri:</b>	Gresa Blakqori	<b>Emri:</b>	Muhadin Halli
<b>Pozita:</b>	E autorizuar	<b>Pozita:</b>	Drejtor i Prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	22.12.2020	<b>Data:</b>	22.12.2020
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

PARAMASA		
Ndertimi i Shtatores të Komandant ADEM JASHARI		
A	Pershkrimi	Cmimi
1	<p>Realizimi i shtatores kushtuar Heroit Kombëtar Adem Jashari sipas kërkesave të specifikuara</p> <p>Shprehja figurative artistike e shtatores duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapësirën e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronzë.</p> <p>Shtatorja si koncept në vehte duhet të jetë shprehje artistike dhe figurative me të cilën kjo reflekton tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari. Kompozimi i shtatores do të përfshijë pamjen figurative të Heroit Kombëtar Adem Jashari. Lartësia e shtatores duhet të jetë (orientuese) 300-350 cm. Materiali i fortë përfundimtar i shtatores është bronzi. Në çmim duhet të kalkulohen të gjitha shpenzimet: punimi i bustit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament, realizuesi i shtatores duhet të shenoj-Gaveroj edhe Emrin Mbiemrin, datën e lindjes dhe te vdekjes.</p>	69,900.00
	<b>Totali</b>	<b>69,900.00</b>

Emri i Kompanisë	Migrant Ing SHPK & Lumjetë Havolli Blakçori B.I
Adresa e Plote	Rr.Illir Soba nr 5 Prishtinë ,,
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	Gresa Blakçori
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	28.08.2020
Vula	





# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta kenë

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 89963

Për **KK Shtimje**

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **Migrant Ing SH.P.K**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Ndertimi i shtatores se komandantit Adem Jashari**

Nr. prokurimit: 617--20-4196-4-2-3 , Nr. brendshëm: 617 20 4196 4 2 3

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **6,990.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:


- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **6,990.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 365 ditë kalendarike prej **22.12.2020** deri më **22.12.2021**

Data lëshimit: 22.12.2020

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit





Nr i Serisë

**0057577**